

ÇFARË ËSHTË REKRUTIMI ETIK?

Sistemi Ndërkombëtar i Integritetit në Rekrutim (IRIS)

Rekrutim etik do të thotë rekrutim i punëtorëve në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente që respekton dhe mbron të drejtat e tyre. Standardi i Sistemit Ndërkombëtar të Integritetit në Rekrutim (IRIS)¹ është një paketë me parime globale që përkufizojnë rekrutimin etik. Standardet IRIS shprehin kuptimin e rekrutimit etik në praktikë dhe mënyrën se si rekrutuesit mund të tregojnë respektimin e tyre.²

Ato bazohen në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të punës dhe janë zhvilluar përmes konsultimeve të gjera të shumë aktorëve.³




Fig.1: Përkufizimi i rekrutimit etik

Standardi IRIS përbëhet nga dy parime të përgjithshme dhe pesë parime specifike. Më poshtë mund të gjeni shtatë Parimet bazë të IRIS.

Parimet e përgjithshme:

A. Respektimi i Ligjeve dhe Parimeve Themelore dhe të Drejtave të Punës – Rekrutuesit duhet të respektojnë të gjithë legjisacionin në fuqi, rregulloret, marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe për migracionin për motive punësimi dhe politikat që lidhen me rekrutimin e punëtorëve migrantë në juridikSIONET e vendeve të origjinës, tranzitit dhe destinacionit, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me imigrimin ose emigrimin e punëtorëve migrantë. Ky parim ndalon në mënyrë të qartë përdorimin e trafikimit të personave, punën e detyruar dhe punën e fëmijëve, dhe përfshin respektimin e të drejtës së lirisë së organizimit dhe marrëveshjeve kolektive dhe respektimin e trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit, siç parashikohet në Deklaratën e ILO-s mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë.

B. Respektimi i Sjelljes Etike dhe Profesionale – Për të respektuar ligjet dhe për të përbushur Parimet IRIS, rekrutuesit do të kenë sisteme menaxhimi, sidomos vigilencën e duhur për t'u siguruar që aktivitetet e tyre të rekrutimit të jenë në përputhje me Parimet IRIS dhe të kryhen në mënyrë të tillë që i trajton punëtorët migrantë me dinjitet dhe respekt, pa ngacmim, ose çdo formë detyrimi ose trajtimi poshtërues ose çnjerëzor.

Parimet specifike:

- 1. Ndalimi i tarifave të rekrutimit dhe kostove të tjera ndaj punëtorëve migrantë** - Rekrutuesit nuk duhet të vendosin, drejtpërdrejt ose jo, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë tarifë ose kosto tjetër ndaj punëtorëve migrantë për shërbimet që lidhen me rekrutimin për vendosje ose punësim të përkohshëm ose të përhershëm.
- 2. Respektimi i Lëvizjes së Lirë** - Rekrutuesit nuk duhet të kërkojnë nga punëtorët migrantë ose anëtarët e familjeve të tyre që të ofrojnë një garanci monetare ose kolateral tjetër si kusht punësimi dhe nuk duhet të mbajnë, shkatërrojnë ose konfiskojnë dokumente, paga ose sende të tjera personale dhe, në këtë mënyrë, të kufizojnë lirinë e lëvizjes.
- 3. Respektimi i Transparencës për Termat dhe Kushtet e Punësimit** - Rekrutuesit duhet të sigurohen që, përpara vendosjes, punëtorët migrantë të pajisen me kontrata me shkrim në një gjuhë të kuptueshme nga çdo punëtor, ku të tregohen me detaje termat dhe kushtet e punësimit, sidomos, por jo vetëm natyra e punës së ndërmarrë, tarifat dhe marrëveshjet e pagesës, orët e punës, pushimet vjetore dhe pushime të tjera dhe të gjitha zbritjet e tjera të ligjshme nga paga dhe përfitimet e punësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar. Rekrutuesit duhet të sigurohen që të merret, pa detyrim, pëlqimi me shkrim i punëtorit.
- 4. Respektimi i Konfidencialitetit dhe Mbrojtja e të Dhënavë** - Rekrutuesit nuk duhet të regjistrojnë, në dosje ose në regjistra, të dhëna personale që nuk kërkohen për të gjykuar aftësitë e punëtorëve migrantë për punën për të cilën ata janë duke u konsideruar ose mund të konsiderohen, ose që kërkohen për të lehtësuar vendosjen e tyre. Rekrutuesit duhet të sigurohen që të gjitha të dhënat personale që ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të trajtohen me konfidencialitet të rreptë dhe të mos i komunikohen asnjë pale të tretë pa pëlqimin paraprak të informuar me shkrim të punëtorit ose përfaqësuesit të punëtorëve, përvçe se nëse kërkohet ndryshe me ligj.
- 5. Respektimi i të drejtës për mjete juridike** - Rekrutuesi duhet të sigurohet që punëtorët migrantë të kenë të drejta efektive për mjete juridike, pa u frikësuar ngaakuza, hakmarrja ose shkarkimi, siç janë procedurat e brendshme të ankesave të rekrutuesit të punës dhe/ose punëdhënësit dhe për ato mjete juridike të parashikuara me ligj në vendin e origjinës dhe destinacionit, në lidhje me aktivitetet e tyre të rekrutimit.

TË DREJTAT E PUNËKËRKUESVE QË MARRIN SHËRBIME OSE TË REKRUTUAR NGA AGJENCITË PRIVATE TË PUNËSIMIT DHE PUNËMARRËSVE TË AGJENCIVE TË PUNËSIMIT TË PËRKOHSHËM

Legjislacioni për punësimin e përkohshëm garanton një sërë parimesh dhe të drejtash për punëmarrësit e përkohshëm dhe detyrimet për agjencitë e rekrutimit dhe institucionet e shtetit.⁴

Cilat janë të drejtat tuaja si punëkërkues të rekrutuar nëpërmjet një agjencie private punësimi?

- Kërkesat e punëkërkuesit trajtohen nga një agjenci private e punësimit e licencuar në kategorinë X.2.A, "Ndërmjetësim në tregun e punës".
- E drejta e punëkërkuesve shtetas shqiptarë për t'u punësuar jashtë shtetit, sipas marrëveshjeve dypalëshe të qeverisë shqiptare me vendet përkatëse, dhe për t'u njojur me marrëveshje të tillë.
- Punëkërkuesit i përfitojnë shërbimet e agjencisë private të punësimit për punëkërkuesit falas, pa asnjë detyrim financiar, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me përashtim të pagesës së shpenzimeve të nevojshme për plotësimin e dosjes administrative të çdo punëkërkuesi.
- Punëkërkuesve i sigurohet trajtim i barabartë nga agjencia private e punësimit.
- Punëkërkuesi i ndërmjetësuar në punë nga agjencia private e punësimit gjëzon të drejtën për negociimin kolektiv, pagën minimale, kohën dhe kushtet e punës, përfitimet e sigurimeve shoqërore, mbrojtjen e pasurisë dhe të shëndetit në punë.
- Punëkërkuesi ka të drejtën të njoftohet nga agjencia private e punësimit për kushtet e punës dhe të punësimit, përpara fillimit të marrëdhënieve të punës.
- Punëkërkuesi ka të drejtën e sigurisë se nuk do të punësohet në vende pune që paraqesin rrezik e pasiguri për jetën dhe shëndetin e tij, apo ku mund të jetë subjekt abuzimi apo trajtimi diskriminues.
- Punëkërkuesi ka të drejtën e sigurisë se përpunimi i të dhënave të punëkërkuesit nga agjencia private e punësimit bëhet duke respektuar konfidencialitetin dhe përdorimin e të dhënave, sipas natyrës së punës dhe nuk përhapet për asnjë lloj tjetër qëllimi, përvèç atij për të cilin janë dhënë, duke përashtuar rastet kur është dhënë pëlqimi me shkrim nga personi që e jep informacionin.

Cilat janë të drejtat tuaja si punëmarrës i përkohshëm i rekrutuar nëpërmjet një agjencie të punësimit të përkohshëm?

- Punëmarrësi i përkohshëm është i punësuar nëpërmjet një agjencie të punësimit të përkohshëm të licencuar në kategorinë X.2.A, "Ndërmjetësim në tregun e punës".
- Punësimi kryhet nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e agjencisë së punësimit të përkohshëm dhe ndërmarrjes pritëse pasi të jetë lidhur kontrata e punës me agjencinë e punësimit të përkohshëm.
- Kontrata me agjencinë e punësimit të përkohshëm nënshkruhet për një periudhë jo më shumë se 2-vjeçare.
- Punëmarrësi i përkohshëm nuk i paguan agjencisë së punësimit të përkohshëm tarifë për punësimin e tij në ndërmarrjen pritëse.
- Punëmarrësve të përkohshëm u ofrohet mundësia për t'u trajnuar si punëmarrës të përhershëm në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e pozicionit ku janë të punësuar nga ndërmarrja pritëse.
- Punëmarrësit e përkohshëm, nëse u përkasin grupeve vulnerabël, sipas legjislacionit në fuqi, mbrohen nga rreziqet që i prekin në mënyrë të veçantë, nëpërmjet mbikëqyrjes së veçantë mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi.
- Punësimi i një punëmarrësi të përkohshëm në ndërmarrjen pritëse ndërpritet nëse:
 - o nëpërmjet punësimit të tij zëvendësohen punëmarrës që ushtrojnë të drejtën e grevës.
 - o punëdhënësi, gjatë 6 muajve të fundit, ka bërë largime nga puna të punëmarrësve të të njëjtit profesion.
 - o për arsyе ekonomike ose, gjatë 12 muajve të fundit, ka bërë largime kolektive, për të njëjtat profesione.
 - o puna, për nga natyra e saj, përbën rrezik për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësit.

REKRUTIMI I DREJTË

Jeni një ndërmarrje, agjenci private punësimi, investitor apo organizatë për të drejtat e punës dhe dëshironi të mbroni punëtorët migrantë?

Atëherë, qasja juaj për mbrojtjen e punëtorëve migrantë duhet të fokusohet veçanërisht tek rrugët dhe mjetet që përdorin punëtorët për të gjetur punë në ekonominë globale!

Kuadri i veprimit për agjencitë private të punësimit dhe ndërmarrjet pritëse

Kuadri i veprimit për Agjencitë Private të Punësimit

- Zhvillon politika të brendshme gjithëpërfshirëse.
- Merrni masa për të rritur ndërgjegjësimin për vulnerabilitetin e punëtorëve migrantë nga trafikimi dhe puna e detyruar.
- Përzgjidhni dhe vlerësoni rekrutuesit.
- Menaxhoni rekrutuesit dhe monitoroni rekrutimin dhe punësimin etik.
- Krijoni një mekanizëm të brendshëm ankesash dhe mbrojtje për sinjalizuesit.
- Merrni masa për të ndikuar pozitivisht në politikat publike për të promovuar masa mbrojtëse për punëtorët migrantë.

Detyrimet

Detyrimet e Agjencive Private të Punësimit

- Agjencia private e punësimit është e licencuar në kategorinë X.2.A, "Ndërmjetësim në tregun e punës".
- Agjencia private e punësimit ofron shërbime:
 - informimi, këshillimit si dhe vlerësimi të kërkesave dhe aplikimeve për ndërmjetësim për punësim;
 - kërkimi të vendeve të punës;
 - ndërmjetësimi për përcaktimin e kushteve dhe të lidhjeve e të marrëdhënieve të punës, ndërmjet punëkërkuesit dhe punëdhënësit.
- Agjencia private e punësimit zbaton të gjitha marrëveshjet dypalëshe të qeverisë shqiptare me vendet përkatëse.
- Shërbimet e agjencisë private të punësimit për punëkërkuesit janë falas.
- Agjencia private e punësimit siguron trajtim të barabartë për të gjithë punëkërkuesit.
- Agjencia private e punësimit njofton punëkërkuesin për kushtet e punës dhe të punësimit, përpara fillimit të marrëdhënieve të punës.
- Agjencia private e punësimit nuk ndërmjetëson për punëkërkuesin në vende pune, që paraqesin rrezik e pasiguri për jetën dhe shëndetin e tij apo ku mund të jetë subjekt abuzimi apo trajtimi diskriminues.
- Agjencia private e punësimit garanton që personeli i saj të ketë kualifikimin dhe trajnimin e nevojshëm për shërbimet që ofron.
- Agjencia private e punësimit bashkëpunon me zyrat shtetërore të punësimit.
- Agjencia private e punësimit merr masa të garantojë respektimin e të dhënave personale të punëkërkuesit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem eshtē e licencuar nē kategorinē X.2.A, "Ndërmjetësim nē tregun e punës".
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem lidd kontratēn e punësimit me punëmarrēsin pér njé periudħej ja mē shumē se 2-vjeċċare.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem siguron trajtim tē barabartē pér tē gjithé punékérkuesit.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem garanton qē personeli i saj ka kualifikimet dhe trajnimin e nevojshem pér sherbimet qē ofron.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem nuk vendos ndaj punëmarrēsit ndonjē tarifē pér punësim nē ndërmarrjen pritese.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem informon punëmarrēsin e punësimit tē pérkoħshem pérpara fillim tē marrēdhēnies sē punës pér rreziqet specifike nē vendin e punës, si dhe pér çdo kualifikim tē veċantē ose aftesi profesionale ose mbikęqyrje tē veċantē mjekësore qē e kérkon puna.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem lidd marrēveshje punësimi me ndërmarrjen pritese.
- Agjencia e punësimit tē pérkoħshem vendos punësimin e punëmarrēsit tē pérkoħshem nē rastin e:
 - a) zéwendësimit tē njé punëmarrësi qē mungon pérkoħesisht;
 - b) rritjes sē ngarkesës sē punës, pérkoħesisht;
 - c) rritjes sē volumit tē punës sezionale;
 - d) realizimit tē njé projekti me afat tē pērċaktuar;
 - e) realizimit tē njé projekti jashté veprimtarisë sē kryer nga ndërmarrja pritese.
- Punësimi i njé punëmarrësi tē pérkoħshem nē ndërmarrjen pritese eshtē i ndaluar nēse:
 - a) me punësimin e tij zéwendësohen punëmarrēsit qē ushtrojnē tē drejtēn e grevës;
 - b) punëdhënësi, gjatë 6 muajve tē fundit ka bérë largime nga puna tē punëmarrēsve tē tē njëjtit profesion, pér arsyé ekonomike ose, gjatë 12 muajve tē fundit, ka bérë largime kolektive nga puna, pér tē njëjtat profesione;
 - c) puna, pér nga natyra e saj, pér bén rrezik pér shëndetin dhe sigurinē e punëmarrēsit.
- Agjencitē e punësimit tē pérkoħshem informojnē ministrinē pērgjegjēse pér česhtjet e punësimit çdo għashté muaj pér strukturēn dhe veprimtarinē e tyre.

Njé Agjencie Private Punësimi i hiqet licenca kur:

- agjencia private e punësimit/personi fizik / juridik (ortaku, aksionari apo anētari i organeve drejtuese tē saj) ka/nē qené i denuar pér vepra penale tē kryera me dashje;
- shkel parimin e barazisë, duke diskriminuar punékérkuesin;
- provohet se ka kérkuar tarifa nga punékérkuesi pér sherbimet e ofruara drejtpērdrejt apo tērhorazi ose ka pranuar pagesa, mallra apo sherbime nga punékérkuesi, pērveç pageses sē nevojshme pér plotësimin e dosjes administrative tē punékérkuesit
- reklamon njoftime tē rreme ose mashtruese pér ndërmjetësimin;
- bén deklarata, dëshmi tē rreme ose pēr dor dokumente tē falsifikuara;
- nxixt drejtpērdrejt apo tērhorazi punékérkuesin tē transferohet nē njé vend tjetër pune, rastit kur transferimi eshtē nē interes tē punékérkuesit;

- ndikon ose përpinqet të ndikojë çdo punëdhënës ose ndërmarrje të mos punësojnë disa persona;
- ofron shërbimet e veta për të miturit;
- angazhohet të ndërmjetësojë për punëkërkuesin në vende pune që cenojnë dinjitetin e Republikës së Shqipërisë
- pengon ose përpinqet të pengojë inspektimin e organeve përkatëse;
- nuk përmbush detyrimet për sigurimet shoqërore apo kontratat e punës për punëmarrësit e vet;
- nuk respekton dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.2.2018 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit".

UDHËZIME PËR REKRUTUESIT

Rekrutimi etik për punëtorët migrantë shtëpiakë

Të drejtat e punëtorëve migrantë pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.⁵ Më poshtë përshkruhen parimet e standardit IRIS në rekrutimin e punëtorëve migrantë shtëpiakë.

Barazi në gjëzimin e të drejtave

- Punëtorët migrantë gjëzojnë të drejtat e parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara.
- Në të gjitha vendimet në lidhje me interesat e tyre, punëtorët migrantë trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Punësimi i ligjshëm

- Punëtorët migrantë punësohen pasi të janë pajisur me leje qëndrimi ose ndonjë autorizim tjetër të ngjashëm që është i vlefshëm për kohëzgjatjen e punësimit në fjalë.
- Kostot e kthimit të çdo të huaj që është punëuar në mënyrë të paligjshme nga një ndërmarrje mbulohen nga punëdhënësi.
- Të gjitha shpërblimet e papaguara për të huajin që është punëuar në mënyrë të paligjshme mbulohen nga punëdhënësi.
- Punëdhënësi paguan çdo taksë ose kontribut social të papaguar, duke përfshirë gjobat administrative përkatëse të zbatueshme për të huajin që është punëuar prej tij në mënyrë të paligjshme.

Ndalimi i tarifave të rekrutimit dhe kostove të tjera ndaj punëtorëve migrantë

- Asnjë tarifë rekrutimi për shërbimet që lidhen me rekrutimin për vendosje ose punësim të përkohshëm ose të përhershëm nuk mund të vendoset ndaj punëtorëve migrantë shtëpiakë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose pjesërisht.
- Punëtorët migrantë nuk duhet të paguajnë asnjë tarifë rekrutimi.

Respektimi i lëvizjes së lirë

- Punëtorëve migrantë shtëpiakë ose anëtarëve të familjes së tyre nuk duhet t'u mbahen pasaportat, si dhe dokumente të tjera identiteti ose dokumente që provojnë punësimin, gjatë të gjitha fazave të procesit të rekrutimit.
- Punëtorëve migrantë shtëpiakë ose anëtarëve të familjes së tyre nuk duhet t'u mbahet asnjë dokument bankar, kartë bankare, dokumente për prona të paluajtshme ose personale në asnjë moment sepse këto janë të panevojshme gjatë procesit të rekrutimit.
- Kontratat e punësimit dhe shërbimit ndërmjet rekrutuesit dhe punëtorëve migrantë duhet të përfshijnë një klauzolë që garanton mos kufizimin e lirisë së tyre të lëvizjes.

Respektimi i transparencës për termat dhe kushtet e punësimit

Punëtorët migrantë shtëpiakë kanë të drejtë të marrin shërbime rekrutimi të parashikuara në marrëveshjet me shkrim me rekrutuesit.

- Rekrutuesit duhet të kenë marrëveshje shërbimi me punëdhënësit (familjen). Rekrutuesit duhet t'u ofrojnë punëtorëve migrantë shtëpiakë kontrata punësimi me shkrim që janë të drejtpërdrejta dhe në një gjuhë të kuptueshme nga punëtori.
- Rekrutuesit duhet të ofrojnë kontrata pune për punëtorët migrantë shtëpiakë përpara se ata të vendosen.
- Kontratat e punësimit duhet të miratohen dhe të nënshkruhen nga punëtorët migrantë shtëpiakë pa asnjë detyrim.
- Rekrutuesit duhet të verifikojnë që termat dhe kushtet e punësimit të janë të njëjta me ato të ofruara fillimisht nga punëdhënësi dhe të janë në përputhje me ligjin dhe praktikën në fuqi.
- Rekrutuesit duhet të sigurohen që kontratat e punësimit të nënshkruara nga punëtorët migrantë shtëpiakë të mos zëvendësohen me kontrata të tjera punësimi, përveç rasteve kur ato janë kontrata me kushte më të mira jetese dhe pune dhe janë të dakordësuara me punëtorët.
- Rekrutuesit duhet të sigurohen që punëtorët migrantë shtëpiakë të marrin trajnim orientimi para nisjes.

Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave

- Të dhënrat personale të punëtorëve migrantë mblidhen vetëm nëse dhe për aq sa janë të rëndësishme për procesin e rekrutimit.
- Të dhënrat personale të punëtorëve migrantë mblidhen, merren, përdoren, transferohen ose ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Të dhënrat personale ruhen në mënyrë të sigurt, si në kasaforta të kyçura ose sisteme elektronike të mbrojtura me fjalëkalim.
- Agjencia ruan të dhënrat personale të punëkërkuesit vetëm për aq kohë sa kjo justifikohet nga qëllimet e nevojshme për të cilat është bërë marrëveshja ose, për aq kohë sa punëkërkuesi dëshiron të mbetet në listën e kandidatëve për mundësi punësimi.

Respektimi i së drejtës për mjete juridike

- Punëtori migrant ka të drejtë të paraqesë një ankesë administrative kundër urdhrit për refuzimin e lëshimit, rinosimit ose anulimit të lejes unike pranë autoritetit vendimmarrës ose autoritetit të tij të drejtpërdrejtë mbikëqyrës.
- Ankesa depozitohet pa pasur frikë për akuzë, hakmarrje ose shkarkim.
- Vendimi i organit mbikëqyrës mund të kundërshtohet në gjykatën kompetente për çështje administrative.
- Rekrutuesit duhet të kenë mekanizmat e tyre, ose të marrin pjesë në mekanizmat efektivë të ankimimit në nivel operacional.
- Rekrutuesit duhet të sigurohen që punëtorët migrantë shtëpiakë të jenë të informuar dhe të kenë mundësi të hapur dhe të drejtpërdrejtë për një mekanizëm ankesash në lidhje me procesin e rekrutimit.
- Rekrutuesit duhet t'u ofrojnë punëtorëve migrantë shtëpiakë informacion rreth mekanizmave të ankimimit të ofruara nga shteti, punëdhënësi dhe industria në lidhje me punësimin si në vendet e origjinës ashtu edhe në ato të destinacionit.



DETYSIMET DHE KUADRI I VEPRIMIT I NDËRMARRJEVE PRITËSE

Cilat janë detyrimet e ndërmarrjes pritëse?

Ndërmarrja pritëse u ofron punëmarrësve të përkohshëm trajnimin e nevojshëm dhe në përputhje me karakteristikat e vendit të punës, njësoj si punëmarrësit e përhershëm. Në këtë mënyrë ndërmarrja pritëse duhet të marrë parasysh kualifikimet dhe përvojën e tyre, për të përmirësuar aftësitë dhe njojuritë e tyre në fushën ku janë të punësuar.

- Ndërmarrja punëson një punëmarrës të përkohshëm nëse:
 - o ka rritje të ngarkesës së punës, përkohësisht;
 - o ka rritje të volumit të punës sezionale;
 - o duhet të realizojë një projekt me afat të përcaktuar;
 - o duhet të realizojë një projekt jashtë aktivitetit të kryer nga ndërmarrja pritëse;
 - o punëmarrësit që ushtrojnë të drejtën e grevës nuk zëvendësohen;
 - o gjatë 6 muajve të fundit nuk ka bërë largime nga puna të punëmarrësve të të njëjtë profesion, për arsyre ekonomike ose gjatë 12 muajve të fundit nuk ka bërë largime kolektive për të njëjtat profesione;
 - o puna, për nga natyra e saj, nuk përbën rrezik për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësit.
- Ndërmarrja mbron punëmarrësit e punësuar nëpërmjet agjencive të përkohshme nga rreziqet që i prekin në veçanti për shkak të punësimit në punë që u përkasin grupeve vulnerabël, sipas legjislacionit në fuqi.
- Punëdhënësi siguron mbikëqyrje të veçantë mjekësore për këtë kategori punëmarrësish.

Kuadri i veprimit për ndërmarrjet pritëse

Ndërmarrjet mund të kryejnë shumë hapa brenda veprimtarisë dhe zinxhirëve të tyre të furnizimit për të parandaluar, zbuluar dhe korriguar trafikimin e qenieve njerëzore dhe punën e detyruar të punëtorëve migrantë.

- Zhvillimi i politikave të mira të brendshme mund:
 - o t'ju ndihmojë t'i adresoni këto rreziqe në mënyrë gjithëpërfshirëse, sistematike dhe proaktive përmes zinxhirit tuaj të furnizimit;
 - o të japë një sinjal pozitiv për investitorët, konsumatorët dhe aktorët e politikave publike për angazhimin tuaj për të adresuar këtë abuzim; dhe
 - o të promovojë më tej përpjekjet e zinxhirit të furnizimit për të zbutur rreziqet ndaj vlerës së markës dhe reputacionit të ndërmarrjes.

- Integrohuni brenda sistemit të menaxhimit të biznesit dhe politikave të formuluara qartë për të parandaluar shfrytëzimin e punëtorëve migrantë
 - Përmirësoni kodet e sjelljes dhe politikat e ndërmarrjes;
- Komunikoni drejtpërdrejt me të gjithë stafin e përfshirë në vendime identifikimi dhe pajtueshmërie sociale me këto politika
- Merrni hapa për të rritur ndërgjegjësimin për vulnerabilitetin e punëtorëve migrantë nga trafikimi dhe puna e detyruar
- Siguroni praktika të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore përmes:
 - trajnimeve,
 - shpërndarjes së materialeve edukative,
 - webinare etj.
- Menaxhoni rekrutuesit dhe monitoroni për rekrutim dhe punësim etik duke kryer procedura të brendshme auditimi për mekanizma të fuqishëm korrigues të zhvilluar për të mbrojtur viktimat e mundshme.
- Rritni raportimin dhe transparencën dhe raportimin publik të punës dhe angazhimin me aktorë të tjera për të ndikuar pozitivisht në politikat publike për të promovuar masat mbrojtëse për punëtorët migrantë.

Rekrutuesit mund të:

- identifikojnë rastet që kanë dalë në dritë që kanë të bëjnë me këtë lloj abuzimi;
- jepin me detaje hapat e ndërmarrë për t'i përgjigjur këtyre rasteve;
- diskutojnë sfidat me të cilat janë përballur dhe se si i kanë tejkaluan këto sfida; dhe
- sqarojnë hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë për t'u siguruar që ky lloj problemi të mos përsëritet.
- ilustrojnë me shembuj masat parandaluese, duke përfshirë:
 - ondërmarrin përmirësimin e politikave për të forcuar kodin e tyre të sjelljes;
 - përforcojnë proceset kritike të punës, si rekrutimi, punësimi dhe kompensimi.
- përmirësojnë protokollet e auditimit për të identifikuar më mirë problemet e mundshme;
- rrisin përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit të ndërmarrjes ose zinxhirit të furnizimit;
- trajnojnë dhe forcojnë kapacitetet për furnitorët; ose
- angazhohen në partneritete me palët e interesuara për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore.

DETYRIMET E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

POLITIKAT DHE STRUKTURAT PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE MIGRANTË

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe të punës të punëtorëve migrantë fillon me politikat dhe strukturat dhe masat administrative të duhura

Institucionet shtetërore, të vetëdijshme për detyrimin për të mbrojtur punëtorët migrantë kanë në fokus të dedikuar veçanërisht tek rrugët dhe mjetet që përdorin punëtorët për punësim në ekonominë globale përmes ndërmarrjeve të rekrutimit, d.m.th agjenci private punësimi ose agjenci të punësimit të përkohshëm sipas legjislacionit shqiptar.

Shqipëria ka miratuar ose ka aderuar në kuadrin ligjor ndërkontëtar që lidhet me rekrutimin etik të punëtorëve migrantë:

- Miratoi Konventën e ILO-s për Agjencitë Private të Punësimit, 1997 (nr. 181)
- Miratoi Konventën e ILO-s për Migracionin për Punësim, (të rishikuar), 1949 (nr. 97)
- Miratoi Konventën e ILO-s për Punëtorët Migrantë (Dispozita Plotësuese), 1975 (nr. 143)
- Aderoi në Rekomandimin e ILO-s për Agjencitë Private të Punësimit, 1997 (nr. 188)
- U pajtua me parimet IRIS të IOM-it⁶ dhe Rekomandimet e Montrealit⁷

Shqipëria ka miratuar legjislacionin kombëtar gjithëpërfshirës që përcakton, drejtpërdrejt ose jo, rregullat për rekrutimin e punëtorëve migrantë:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007, nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 88/2012, datë 18.9.2012, nr. 137 / 2015, datë 17.12.2015, nr. 76/2016, datë 22.7.2016, nr. 115/2020, datë 30.7.2020⁸
- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2019-2022 miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 400 datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019-2022".⁹
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.3.1996; nr. 9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015.¹⁰
- Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006 "Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi" i ndryshuar me ligjin nr. 10389, datë 03.03.2011.¹¹

- Ligji nr. 15/2019, datë 13.3.2019 "Për nxitjen e punësimit"¹² (që shfuqizon ligjin nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", ndryshuar me ligjin nr. 8862, datë 7.3.2002, ligjin nr. 9570, datë 3.7.2006 dhe ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002).¹³
- Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 6/2015, datë 12.2.2015, nr. 131/2015, datë 26.11.2015, nr. 37/2016, datë 31.3.2016; nr. 21/2021, datë 22.2.2021, nr. 72/2021, datë 27.5.2021.¹⁴
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, datë 26.4.2012; ligjin nr. 120/2014, datë 18.9.2014.¹⁵
- Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt", datë 24.6.2021.¹⁶
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera", ndryshuar me VKM nr. 1295, datë 29.12.2009; nr. 385, datë 19.5.2010; nr. 436, datë 16.6.2011; nr. 956, datë 9.5.2012; nr. 421, datë 15.5.2013; nr. 26, datë 20.1.2016; nr. 107, datë 10.2.2016; nr. 827, datë 23.11.2016; nr. 301, datë 5.4.2017; nr. 34, datë 22.1.2020.¹⁷
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.02.2018, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit".¹⁸
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 21 maj 2018, "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm" ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 31.7.2019.¹⁹

Shqipëria ka caktuar institucione dhe ka marrë masa administrative për të vlerësuar politikat dhe funksionimin e Agjencive Private të Punësimit dhe Agjencive të Punësimit të Përkohshëm

Cilat janë detyrimet e institucioneve shtetërore?

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kryen kontolle periodike për të përcaktuar përputhjen e veprimtarisë së agjencisë së punësimit të përkohshëm me legjislacionin përkatës.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kur vëren shkelje njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit.

Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit informohet çdo gjashtë muaj nga agjencitë e punësimit të përkohshëm për strukturën dhe veprimtarinë e tyre.

Për çdo shqetësim, ju lutemi kontaktoni:

**Politikëbërja për Agjencitë Private të Punësimi dhe Agjencitë e Punësimit
të Përkoħshem dhe Monitorimi i Agjencive Private të Punësimit /
Agjencive të Punësimit të Përkoħshem**

Institucioni përgjegjës: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë, Shqipëri.
Email: info@financa.gov.al | Nr. Tel: +355 422811133
www.financa.gov.al

**Zhvillimi i politikave të migracionit dhe lejet e qëndrimit të punëtorëve
migrantë**

Institucioni përgjegjës: Ministria e Brendshme

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, H. 1, 1001. Tiranë, Shqipëri.
Email: ministria.brendshme@mb.gov.al
www.mb.gov.al

**Hartimi i udhëzimeve standarde për shërbimet konsullore për
punëtorët migrantë**

Institucioni përgjegjës: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Adresa: Bulevardi 'Gjergj Fishta', Nr 6. Tiranë, Shqipëri.
Email: koordinatorimfa@mfa.gov.al
www.mfa.gov.al

**Organe bashkëpunëtore me agjencitë për informacione, njoftime për
vende të lira, këmbim të dhënash, bashkëpunime dhe forcim kapaciteti**

Institucion përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Email: kontakt@akpa.gov.al | Nr. Tel: +35544538827
www.akpa.gov.al

**Licencimi i Agjencive Private të Punësimit dhe Agjencive të Punësimit
të Përkoħshem**

Institucion përgjegjës: Qendra Kombëtare e Biznesit

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve. Tiranë.
e-mail: info.qkb@qkb.gov.al | Tel: +355 4 2250066
www.qkb.gov.al

Të drejtat e njeriut

Institucionet përgjegjëse:

Avokati i Popullit

Adresa: Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 2. Tiranë, Shqipëri.
Email: ap@avokatipopullit.gov.al | Tel: 04 2 380 300 / Tel: 04 2380 333
Nr. i Gjelbër: 0800 1111 / Nr Cel: +355 68 903 4648
www.avokatipopullit.gov.al

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Adresa: Rruga "Durrësit" Nr.27. Tiranë, Shqipëri.
E-mail: info@kmd.al | Nr. Tel: + 355 4 243 1078
www.kmd.al

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Kodi postar 1001. Tiranë, Shqipëri.
E-mail: info@idp.al
Nr. Tel: +355 42237200 | FAX: +355 42233977 | Nr. i Gjelbër: 08002050
www.idp.al

Programe administrative inspektimi për Agjencitë Private të Punësimit dhe Agjencitë e Punësimit të Përkohshëm

Institucionet përgjegjëse:

Inspektorati Shtetëror Qendror

E-mail: info@insq.gov.al | Nr. Tel: +355 694835881
www.insq.gov.al

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Adresa: Rruga "Sheh Ahmet Pazari, Nr.10, Tiranë, Shqipëri.
Email: info@sli.gov.al
www.sli.gov.al

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Adresa: Rruga "Aleksander Moisiu" nr. 80, Tiranë, Shqipëri.
E-mail: info@ins-shendetesor.gov.al | Nr. Tel: +355 42 235925
www.ins-shendetesor.gov.al

REFERENCA

1. <https://iris.iom.int/sites/g/files/tmzbdl201/files/documents/IRIS%20Standard%20Report%20.pdf>
2. <https://iris.iom.int/iris-standard>
3. Është në përputhje me instrumentet ekzistuese ndërkontinentale të drejtave të njeriut, Konventat dhe standartet e ILO-s, Parimet e Përgjithshme dhe Udhëzimet Operacionale të ILO-s për Rekrutimin e Drejtë, Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe me angazhimet, parimet, kodet dhe praktikat e mira në lidhje me sektorin privat, duke përfshirë industrinë e rekrutimit.
4. Legislacioni mbi të cilin krijohen dhe ushtrojnë aktivitetin këto agjenci përfshin:
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar
 - Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003, ligjin nr. 10 053, datë 29.12.2008, ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015
 - Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006 "Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi", ndryshuar me ligjin nr. 10389, datë 3.3.2011
 - Ligji Nr. 15 / 2019 datë 13.3.2019 "Për nxitjen e punësimit",
 - Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 6/2015, datë 12.2.2015; nr. 131/2015, datë 26.11.2015; nr. 37/2016, datë 31.3.2016; nr. 21/2021, datë 22.2.2021; nr. 72/2021, datë 27.5.2021
 - Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, dhe nr. 120/2014
 - Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt", datë 24.6.2021
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera", ndryshuar me VKM nr 1295, datë 29.12.2009; nr. 385, datë 19.5.2010; nr. 436, datë 16.6.2011; nr. 956, datë 9.5.2012; nr. 421, datë 15.5.2013; nr. 26, datë 20.1.2016; nr. 107, datë 10.2.2016; nr. 827, datë 23.11.2016; nr. 301, datë 5.4.2017; nr. 34, datë 22.1.2020; nr. 805 datë 20.12.2021
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.02.2018, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit".
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 21.05.2018, "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm" ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 31.7.2019, etj.

5. Punëtorët migrant bazuar në ligjin shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003, ligjin nr. 10 053, datë 29.12.2008, ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015
- Ligji nr.9668, datë 18.12.2006 "Për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi", ndryshuar me ligjin nr.10389, datë 3.3.2011
- Ligji Nr. 15 / 2019 datë 13.3.2019 "Për nxitjen e punësimit",
- Ligji nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 6/2015, datë 12.2.2015; nr. 131/2015, datë 26.11.2015; nr. 37/2016, datë 31.3.2016; nr. 21/2021, datë 22.2.2021; nr. 72/2021, datë 27.5.2021
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, dhe nr.120/2014
- Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt", datë 24.6.2021
- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera", ndryshuar me VKM nr 1295, datë 29.12.2009; nr. 385, datë 19.5.2010; nr.436, datë 16.6.2011; nr.956, datë 9.5.2012; nr.421, datë 15.5.2013; nr.26, datë 20.1.2016; nr.107, datë 10.2.2016; nr. 827, datë 23.11.2016; nr.301, datë 5.4.2017; nr. 34, datë 22.1.2020; nr.805 datë 20.12.2021
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.101, datë 23.02.2018, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të agjencive private të punësimit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.286, datë 21.05.2018, "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm" ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 31.7.2019

6. <https://iris.iom.int/sites/g/files/tmzbdl201/files/documents/IRIS%20Standard%20Report%20.pdf>

7. <https://publications.iom.int/system/files/pdf/the-montreal-recommendation.pdf>

8. <https://qbz.gov.al/previe%C3%A9/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

9. <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/THE%20NATIONAL%20STRATEGY.pdf>

10. <https://qbz.gov.al/previe%C3%A9/c1c18a6c-5f3e-457d-b931-de505b3c7ed0>

11. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/12/18/9668>

12. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/03/13/15>

13. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/1995/09/20/7995>

14. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/02/23/10081>

15. <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2008/03/10/9887>

16. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/162/8f6d9e67-0996-44fa-aadb-4a32b30e7fad;q=Ligj%20nr.%2079%2F2021,%20dat%C3%AB%2024.6.2021>

17. <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2009/05/26/538>

18. <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/02/23/101>

19. <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/05/21/286>

Ky libërth është prodhuar në kuadër të projektit "Forcimi i kuadrit të migracionit përmotivë punësimi në Shqipëri", financuar nga Fondi i Zhvillimit të IOM-it dhe zbatuar nga IOM në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, INSTAT, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Botimi synon të promovojë praktikat e rekrutimit etik duke informuar punëmarrësit mbi të drejtat e tyre, dhe detyrimet e punëdhënësve, agjencive private të punësimit dhe të punësimit të përkohshëm dhe institucioneve të shtetit për të respektuar të drejtat e njeriut dhe të punës të punëtorëve migrantë.

***Informacioni që përfshihet në këtë libërth nuk është shterruar. Përmë shumë referojuni akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për agjencitë private të punësimit dhe agjencitë e punësimit të përkohshëm.**

Në brendësi do të gjeni:

- Çfarë është Rekrutimi Etik?
- Të drejtat e punëkërkuesve që marrin shërbime ose të rekrutuar nga agjencitë private të punësimit dhe punëmarrësve të agjencive të punësimit të përkohshëm.
- Detyrimet dhe kuadri i veprimit mbi rekrutimin e drejtë për agjencitë private të punësimit dhe të punësimit të përkohshëm dhe ndërmarrjet pritëse.
- Udhëzime për rekrutuesit mbi rekrutimin etik për punëtorët migrantë shtëpiakë.
- Politikat dhe strukturat për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të punës, për punëtorët migrantë.

Tiranë, 2022